

Përmbi za që lshon bylbyli

Meditime rreth gjuhës sonë të bukur amtare

Nga Ajet Nuro

Tribuna Shqiptare

Këto ditë është hapur një debat në Tribuna Shqiptare mbi gjuhën shqipe dhe dy janë temat që janë trajtuar: gjuha e njësuar shqipe dhe alfabeti. Së pari, dua ti falenderoj të gjithë ata që kanë marr pjesë në diskutime duke e bërë këtë me një respekt të pasqor ndaj njëri-tjetrit. Kjo ka një rëndësi të jashtëzakonshme kur bëhet fjalë për debate të qytetëruara. Duke qenë se më duhet ti publikoj opinionet rreth kësaj teme të nxehtë nuk kam dashur të ndërhyj duke rujatur në njëfarë mënyre një farë neutraliteti. Por, herë mbas here edhe unë jam shprehur për probleme të ndryshme të gjuhës shqipe, ndërsa këtë herë do të doja të flisja pak më gjatë.

Kush duhet të diskutoj për gjuhën shqipe?

Kam dëgjuar ditët e fundit reagime si « ti nuk je gjuhëtar dhe nuk ke të drejtë të flasësh për gjuhën shqipe...» apo edhe të tjera mendime të këtij lloji. Dihet që mendimi i një gjuhëtar, fjala vjen, mendimi i Prof. Emil Lafe është një mendim i specializuar dhe askush nuk mund ti thotë « s'ke të drejtë të diskutosh për gjuhën shqipe » por, veç kësaj kategorie siç janë gjuhëtarët, ka edhe mësues të gjuhës shqipe, ka gazetarë, ka shkrimtarë, ka poetë që gjuhën shqipe e kanë materialin bazë me të cilët ata punojnë dhe na dhurojnë ne « konsumatorëve » veprat e tyre, artin e tyre. Nga ana tjetër, gjuha është e të gjithëve dhe secili ka të drejtë të thotë fjalën e vetë, me një kusht që të dij ta thotë atë. Në një shoqëri të emancipuar dhe demokratike marrja e mendimit të konsumatorëve, në rastin tonë, konsumatorëve të gjuhës shqipe, është pasuria më e madhe nga e cila mund të përfitoj një shoqëri. Janë intelektualët ata që udhëheqin debatet në shoqëri dhe mendimi i njerëzve të thjeshtë i ndihmon ata të shikojnë ku janë ata vetë në raport me dëshirat me mendimet e atyre që e përdorin gjuhën. Nëse një vendim do tu lihej shkencëtarëve, përse do të duheshin sondazhet apo studimet mbi sjelljet e konsumatorëve?!... Elementi që e dallon gjuhën është fakti se ajo prek në nervin tonë nacionalist dhe për këtë arsye jo pak njerëz kur debatojnë, para se të përdorin një argument, nxjerrin një ... « ti je një armik i shqipes, ti je një armik i kombit tonë... » Madje, ka nga ata që thonë se nuk është koha për të diskutuar për gjuhën. Unë do të thosha se koha për të diskutuar për gjuhën është gjithmonë. Gjithmonë gjuha ka nevojë për tu pasuruar, për tu mbrojtur, për tu zhvilluar, për tu bërë pjesë e zhvillimit tonë ekonomiko-shoqëror. Jam dakord nga ana tjetër që qëllimi final i diskutimit rreth gjuhës shqipe të ketë bashkimin tonë si komb. Nëse ka një element rreth së cilit ne shqiptarët

mund të bashkohemi pa i kërkuar leje Ban Ki Mun-it apo edhe shteteve të tjera të këtij planeti, ajo është gjuha jonë. Nga ana tjetër nëse ka një element që mund të bëjë atë që as serbët nuk ia dolën dot ta bëjnë, pra ndarjen e shqiptarëve edhe kjo është gjuha. Për të ilustruar këtë ide po u kujtoj se bullgarë e maqedonas do të ishte e njëjta gjë nëse maqedonasit nuk do thoshin « Jo, ne nuk jemi bullgarë por jemi maqedonas dhe flasim maqedonisht ». Prandaj, nëse ndokush do mendoj se flet kosovarçe apo labçe shpresoj të mos mendoj se ka ndonjë kombësi që mund ti shkoj përshtat kësaj “gjuhe”. Shqiptarët kanë një gjuhë dhe dhjetra dialekte.

Gjuha shqipe, është gjuha e të gjithë shqiptarëve.

Kush mendon se shqiptarët janë komb dhe duhet të bashkohen, bashkimi vjen nga integrimi që mund të jetë ekonomik dhe kulturor. Integrimi i rrëzon vet barrierat që mund të jenë sot mes shteteve ku jetojnë shqiptarët, përfshi edhe dy shtetet zyrtare të shqiptarëve, Shqipëria dhe Kosova. Nuk dua të zgjatem në këtë çështje se hyjmë në debate politike që dalin nga tema veç se dua të theksoj se zhvillimi i një gjuhe të përbashkët nuk është në kundërshtim të asnjë marrveshje ndërkombëtare dhe nuk ka forcë që ta ndaloj. Në këtë kuptim gjuha shqipe e përbashkët merr rëndësi të jashtëzakonshme.

Kongresi i drejtshkrimit i vitit 1972

Pavarësisht nga reagimet që mund të shkaktoj kjo ngjarje, kongresi i drejtshkrimit i vitit 1972 ka qenë ngjarja më e madhe e periudhës kur shqiptarët vuanin murtajën komuniste. Arritja e një marrveshje të tillë prej shqiptarëve siç është krijimi i një gjuhe letrare të përbashkët është një vendim që i kalon kufijtë e gjuhës dhe është baza e mbajtjes gjallë të nacionalizmit të shqiptarëve në kuptimin pozitiv të fjalës. Vet fakti që kongresi mblodhi në një sallë shqiptarët nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe arbëreshët e Italisë është domethënës po aq sa edhe adoptimi i gjuhës së njehsuar shqipe. Por, duke adoptuar dialektin tosk si baza e gjuhës letrare kombëtare, kur Shqipëria jetonte nën diktaturën komuniste të dominuar nga toskët (të paktën diktatori kishte lindur në Jug të Shqipërisë), bënë që kongresi dhe produkti i saj, gjuha e njehsuar, të bëhen pre e kritikave të atyre që do të donin që gegërishtja të ishte baza e gjuhës letrare kombëtare. Nuk kam ndërmend të analizoj kongresin por duke u nisur nga teoria deduktive (ndikimi i regjimit në letërsi apo edhe në shkencat e tjera shoqërore) mund të themi se kongresi duhet të ketë qenë i influencuar nga regjimi i Tiranës. Në çfarë mase u ndikua kongresi dhe si do të ishin rezultatet nëse ai do të zhvillohej jashtë çdo influence politike, u takon atyre që ishin dëshmitar të kësaj ngjarjeje dhe atyre që mund ta studiojnë nga afër. Por, megjithë mangësitë, megjithë adoptimin i toskërishtes si baza e gjuhës letrare kombëtare, kjo nuk do të thotë se sot duhet ti rikthehemi atij vendimi dhe të shkatërrojmë produktin e saj. Nuk e them këtë pse unë kam lindur në Jug aty ku është edhe baza e gjuhës son letrare kombëtare. Gjithsesi jo. Ashtu si Italia (por edhe shumë gjuhë moderne kombëtare...) adoptoi toskanishten e Dante Aligerit dhe e ngriti nga

dialekt në gjuhë mbarëkombëtare, ashtu dhe shqipja u mbështet tek toskërishtja, gjuha e Naim Frashërit. Në fund të fundit diçka duhet sakrifikuar. Problemi është sa vend i është lënë dialektit tjetër. Ashtu siç e ka theksuar Prof. Eshref Ymeri në një artikull të ditëve të fundit ku thekson « *Por këtu nuk mund të mos ritheksoj se shqetësimi kryesor i zotit Elezi përmbledhet në faktin që gegërishtes iu mohua pasuria leksikore në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe që Akademia e Shkencave botoi në vitin 1980. Për këtë qëllim ai, me nismën e vet, mori përsipër një punë me të vërtetë kolosale për “zhvarrosjen” dhe nxjerrjen “në dritën e diellit” edhe të 41 mijë fjalëve “të burgosura” të gegërishtes »¹ Unë do të thoshia që veç aspektit leksikor, duhet parë edhe pasurimi i gramatikës së shqipes dhe ridimensionimi i gegërishtes brenda gjuhës së sotme letrare. I takon specialistëve të përcaktojnë detajet e këtij rigjenerimi që duhet të pësoj gjuha. Pra në vend që të vazhdojmë ti kthehemi rishikimit të vendimit të kongresit të drejtshkrimit të vitit 1972, le ti përkushtohemi pasurimit të gjuhës letrare të adoptuar prej tij, dhe pasurimi i saj vjen nga elementët e munguar të gegërishtes. Në të njëjtën kohë ne duhet të jemi të interesuar sa në pasurimin e gjuhës sonë të letrare kombëtare aq edhe në ruajtjen, sa të jetë e mundur e dialekteve që e pasurojnë gjuhën letrare. Në këtë kontekst, botimi i gazetave në dialekt siç është gazeta e Migjen Kelmendit nuk duhet marr si kërcënim ngaj gjuhës së njehsuar por si pasurim i saj. Sigurisht përsa kohë nuk nxisim krijimin e një shtypi vetëm në gegërisht apo vetëm në toskërisht. Botime të veçanta në dialekt duhet të shërbejnë si laborator i pasurimit të shqipes.*

Rreziqet që i kanosen gjuhës shqipe

Në këto kohë moderne që po jetojmë, kur informatika dhe interneti por edhe realiteti i ri politik i pas viteve '90, e kanë demokratizuar shprehjen e mendimit të lirë, gjuha ka marr një rëndësi të dorës së parë por edhe është ekspozuar nga rreziqe që më parë nuk egzistonin. Nuk po flasim për gjuhën e përdorur në çate (e dini rregullin sipas së cilit nuk shkruajmë kurr fjalën të plotë por të cunguar si pash tung, lol, flm etj etj sepse unë nuk jamë anëtar i këtyre klubeve...) por për gjuhën e përdorur në faqe serioze në internet por edhe për shtypin e shkruar dhe atë audio-vizual respektivisht radio dhe televizion, pra në media. Në parantez po u bëjë një rrëfim: - Një gazetar më shkruan shpesh nga Tirana dhe me sa kuptoj unë ai boton shkrime në shumë gazeta. Pasi më dërgon shkrime gazetash më dërgon oferta hotelesh. Mirpo prej mëse një viti e-maillet e tij i kaloj direkt në SPAM pra në emaillet që sistemi i konsideron si reklama të padëshirueshme dhe arsyeja e këtij veprimi tim nuk janë mesazhet për hotele... Arsyeja e vetme është përdorimi i barbarizmave pa doganë dhe shpesh mungesa e lidhjes logjike në atë çfarë ai shkruan dhe kjo pasi ai dëshiron të shprehet me fjalë sa më të mëdha. Kjo e fundit nuk ka të bëjë me çështjen që po diskutojmë por problemi më i madh për mua është përdorimi i fjalëve të huaja. Dhe kjo është një sëmundje sidomos e gazetarëve që jetojnë në Shqipëri e Kosovë. Shumë rrallë e ndeshim këtë fenomen tek intelektualët shqiptarë

1 Prof. Eshref Ymeri « Rikthim të një temë e kahershme » - TribunaShqiptare.com
<http://tribunashqiptare.com/news/132/ARTICLE/3207/2010-01-05.html>

që jetojnë në botën e jashtëme dhe që shkruajnë herë mbas here në shtypin e përditshëm të Tiranës apo Prishtinës. Duke dashur të gjejmë aryet për të shpjeguar këtë tendencë, mund të imagjinojmë arsye si ajo dëshira për tu dukur sa më perëndimorë, sa më poliglotë (shumë gjuhësh) apo sa më modern. Le të pranojmë se shqiptarët që jetojnë nëpër botë jetojnë me një gjuhë tjetër dhe ndodh që ata të bien pre e kësaj gracke. Nga përvoja personale mund të them se ndonëse urrej përdorimin e fjalëve të huaja të panevojshme, herë-herë edhe unë përdor fjalë të huaja që janë të vështira të dallohen nga fjalët shqipe. Për të qenë më i qartë, kur na duhet të përkthejmë fjalën frënge « *ambiance* » fjala mund të përkthehet mjedis por në shqip përdoret edhe ambient dhe kuptohet që kur « *jeton* » me *ambiance* është e vështirë të të vijë në mendje mjedisi...

Ky problem nuk është veç shqiptar por pak a shumë ndërkombëtar. Ka shtete ku qeveritë kanë ndërhyrë për ta mbajtur gjuhën të pastër. Dhe këtë e bëjnë me mjete presioni. Le të përmendim këtu Francën. Por nuk do të mjaftonte ndërhyrja e qeverisë. Vet folësit e një gjuhe duhet të mobilizohen. Në rastin tonë, i duhet thënë ndal përdorimit të fjalëve të huaja të panevojshme. Nga ana tjetër, institucionet shkencore të ngarkuara me studimet e gjuhës duhet të ndërhyjnë dhe të ndihmojnë në pranimin e fjalëve të huaja që mund të pranohen në gjuhën shqipe, në krijimin e fjalëve që nuk egzistojnë për terma të rinjë. Edukimi i të rinjëve në shkolla apo edhe nëpërmjet botimeve të spacializuara duhet të ndikoj gjithashtu. Ndërsa sektori provat mund të ndihmoj me krijimin e çmimeve për mediat që respektojnë gjuhën shqipe apo me anë të konkureseve të ndryshme. Barbarizmat janë një rrezik për gjuhën. Mendoni se ç'kërkojnë në gjuhën shqipe fjalë si *performancë*, *trendi*, *draft* për të përmendur veç disa raste të përdorimit të fjalëve të huaja. Para disa ditësh një shkrim kritik për festivalin e këngës në RTV, shkruar nga Pilo Zyba bënte fjalë pikërisht për përmbajtjen e shqipes nga barbarizmat dhe pikërisht në një aktivitet aq të rëndësishëm si ky që po përmendim. Shkrimi i zotit Zyba (ndoshta nuk është i vetmi...) duhet të shërbej si kabanë alarmi për të gjithë ata që i shqetëson pastërtia e gjuhë sonë nga fjalët e huaja.

Alfabeti i gjuhës shqipe

Alfabeti i gjuhës shqipe që ne përdorim sot është frut i Kongresit të Manastirit që u mbajt në Manastir në vitin 1908. Miratimi i një alfabeti latin nga ana e kongresit, ka qenë një fitore për gjithë shqiptarët. Kjo rëndës ka anën e vetë politike dhe morale pse i bënte shqiptarët të mos vareshin as nga turqit, as nga grekët dhe as nga sllavët, por edhe nga ana teknike e bënte të lehtë pajisjen me mjete si shtypshkronja e makina shkrimi nga Perëndimi. Por a ka difekte alfabeti i gjuhës shqipe?

As që do bëhej një pyetje e tillë para viteve '90. Problemet me alfabetin e gjuhës shqipe vijnë nga disa shkronja të vështira për tu shkruar nga të gjitha tastierat e kompiuterave dhe të vështira për tu pasqyruar edhe në faqet e internetit. Të tilla janë shkronjat /ë/ dhe /ç/. Problemin e ka ngritur intelektual dhe publicisti zoti Bashkim Kopliku.

Para se të jap mendimin tim dua të them dy fjalë për zotin Kopliku. Zoti Kopliku është

një intelektual me një kulturë të gjerë dhe të gjithanëshme. Kur ai trajton një çështje e ka studiuar mirë dhe e argumenton me prova të pakundërshtueshme. Nga ana tjetër ai është një diskutues jashtëzakonisht i duruar. Edhe kur ndonjëri e shan (nuk flasim për kritika...) ai gjen kohën ti përgjigjet me argumenta dhe me një urtësi e gjakftohtësi të tillë që do t'ia uroja çdo debatuesi, madje edhe vehtes sime. Nuk dua të shkruaj gjithë sa ai propozon por po shkruaj veç një element të propozimit të tij. Ai propozon ndryshimin e /ë/ me /f/ pasi kjo të zvendësohet me /ph/ dhe ndryshimin e /ç/ me /cs/. Meqenëse propozimi për ndryshimin e alfabetit vjen prej tij, pyetja është: Është e drejtë të mendojmë një ndryshim të alfabetit? Përgjigja vjen nga përvoja botërore: -Po. Ka shumë vende që për një arsye apo për një tjetër kanë propozuar dhe kanë bërë ndryshime në alfabetin e tyre. Më 1928, Mustafa Qemal Ataturku e ndryshoi komplet alfabetin turk duke e romanizuar atë. Por edhe gjermanët kanë bërë ndryshime jo më larg se viti 2005 dhe ndryshimet që ata kanë bërë ngjajnë me ndryshimet e propozuara nga zoti Kopluku. Pra nuk ka vend për të akuzuar zotin Kopluku se po kërkon të shkatërroj gjuhën shqipe apo alfabetin e saj. Përkundrazi, shqetësimi i tij është mëse i drejtë dhe i justifikuar.

Ndryshimet në rregullat e një gjuhe apo në alfabetin e saj bëhen nga specialist dhe kjo pas studimeve që ndërmarrin komisione të posaçme. Pra, nuk më takon as mua dhe askujt që dikton për këto ndryshime për të vendosur. Por, kjo nuk më pengon të jap edhe unë mendimin tim. Duke përgëzuar guximin e atyre që janë për ndryshimin e alfabetit, **unë nuk jam për një veprim të tillë.** Së pari, ne duhet të tentojmë të përshtasim teknologjinë me karakteristikat e alfabetit të gjuhës shqipe. Frëngjishtja i ka të dy format grafike për të cilat bëhet diskutimi i ndryshimit pra edhe /ç/ edhe /ë/. Madje, frëngjishtja ka edhe forma të tjera që bëhen problematike si /é/, /è/, /ê/, /ô/ etj etj. Unë kam përdorur dhe përdor sisteme të ndryshme shfrytëzimi kompiuterash si windows, linux dhe mac dhe të gjithë kanë mundësi të përshtatësh tastierën në gjuhën e duhur. Unë përdor sistemet në gjuhën angleze (software) me tastierën në gjuhën franceze kanadeze (software dhe hardware). Me sa di unë shumë sisteme kanë të integruar gjuhën shqipe (software) por besoj se duhet të ketë edhe tastiera në gjuhën shqipe (hardware), pra tastiera që të kenë butonat me shkronjat në fjalë.

Së dyti dhe kjo mendoj se është më e rëndësishme; efekti psikologjik i ndryshimit. Të kërkoesh ndryshimin e alfabetit do të thotë të mësosh dy alfabete, të riun dhe të vjetrin (sepse nuk mund të hedhim poshtë një libër të shkruar me një alfabet të vjetër...) Do të jetë e lehtë për ne që jemi mësuar gjithë jetën me /ë/ dhe /ç/ të ndryshojmë e të përshtatemi me dy forma grafike të tjera?!

Edhe njëherë, ky është mendimi im. U takon të gjithë përdoruesve të gjuhës shqipe dhe specialistëve të saj të thonë fjalën e tyre nëse janë apo jo për një ndryshim të alfabetit tonë.

Së fundi dua të shpreh atë entuziazëm dhe atë krenari që e ka shprehur Ndre Mjeda para mëse një shekulli për bukurinë e gjuhës shqipe të cilën duhet ta ruajmë dhe pasurojmë:

Përmbi za që lshon bylbyli
Gjuha shqipe m'shungullon...

Ajet Nuro
anuro@albemigrant.com
Montreal, Kanada, 14 janar 2010